

## **Rregullat shkollore në shkollën fillore Toni Schruf- Verzioni për Prindër**

Sa i përkëtë bashkëjetesës edhe pse jemi shumë njëzëz të ndryshëm në mundohemi që në kornizën e rregullave shkollore të jemi sa më të bashkuar dhe kështu do të kemi sukses. Ne deshirojmë dhe kerkojmë nga të gjithë të pranishmit të respektojnë rregullat e mirësjelljes, ku për menyrën e mirësjelljes semirë dhe të ndersjellit e konsiderojmë si shumë të vlefshëm. Na kushton shumë mund që të jemi të gatshëm për ndihmë dhe me plotë mirëkuptim të sjellimi mirë dhe të kemi të gjithë sebashku kujdes për njerëzjet, vetëm kështu do të kemi përparim dhe sjellja jonë do të na shpërblehet!!

**Një përshëndetje e përzemert sjellë një atmosferë të këndshëm në shkollë.**

### **Koha e Kujdestarisë ose( në kuader të kujdestarisë dhe mbikëqyrjes)**

- ❖ Hyrja në objektin shkollore është në orën 7.25h, nxënësit janë nga mësimdhënësit kujdestar të përkujdesur.
- ❖ Para orës 7.25h nxënësit që udhetojnë me autobus, kanë të drejtë të hyjnë në hyrje të shkollës ,në katin përdhësë ata nuk janë të përkujdesur nga askush.
- ❖ Nxënësit që udhetojnë me autobus kur është koha e keqe mund të qëndrojnë në shkollë në partë të objektit shkollore deri sa të vije koha e autobusve, edhe në këtë rast nuk janë të përkujdesur nga askush.
- ❖ Kujdestarija(Mbikëqyrja) e nxënësve fillon 15 min. para se të fillojnë aktivitetet shkollore ose mësimi i paraditës, dhe zgjatë deri sa të gjithë nxënësit dalin nga klasët mësimore respektivisht nga objekti shkollore
- ❖ Gjatë orëve të mësimi , por edhe gjatë pausës nxënësit nuk guxojnë që të largohen jashtë objekti shkollore ,pa lejen e shkruar dhe të nënshkruar nga prindërit
- ❖ Nxënës që vonohen në shkollë , duhet të tregojnë mësuësit arsytë e vonësës
- ❖ Pasi që mesimi të kryhet , Nxënësit nuk kanë të drejtë të qëndrojnë ma gjatë në objektin shkollore

### **Prindërit në objektinshkollor**

- ❖ Në këtë shkollë në kemi rreth 260 fëmijë. Prindërit janë të lutur që fëmijët e tyre para dhe pasë orarit mësimorë, të sjellin dhe të marrin ata, para hyrjes kryesore të objektit shkollore
- ❖ Hyrja e prindërve në klasë nuk është e dëshirueshme
- ❖ Për ndonjë pyetje ose shqetsim, kontaktoni me kujdestarën e klasës dhe caktoni një termin, apo për një konsultim siq është me plan i paraparë

## **Sjelljet gjatë kohës mësimore**

- ❖ Kualiteti thelbesorë i mësimi dhe i aktiviteteve tjera shkollore , mvaret nga sjelljet e nxënësve
- ❖ Ne qe tani kemi vendosur, që nxënësat kur të filloj ora mësimore duhet ti kanë të gjitha mjetet mësimore të përgaditura
- ❖ Vijimi (Pjesëmarrja e) i rregulltë në mësim, si ne ato lëndë të detyruara, dhe në ato lëndët e pa detyruara ( të lira) ku prindërit i kanë lajmerua dhe nënshkruar, vijimi i rregullt është i detyruar.

## **Rregullat dhe Sjelljet në objektin shkollor**

- ❖ Ne kujdesemi për rregullat ,pastertinë në objektin shkollorë dhe për dhomat mësimore.Cdo njëri prej nesh mbanë përgjegjësin e njejtë.
- ❖ Ne kujdesemi se bashku për ambientin, ndarjen e mbeturinave(berllogut) si dhe ti kursejmë burimet energjetike.
- ❖ Hyrja dhe Dalja në Objektinshkollorë është vetëm në hyrjen kryesore të shkollës.
- ❖ Në objektin shkollorë të gjithë fëmijët janë të obliguar të mbathin papuqe.
- ❖ Nxënës-at janë të detyruar ti ndegjojnë urdhërat dhe udhëzimet e të gjithë mësimdhënësve.
- ❖ Nxënës-at duhet të sillen mirë të jenë korrekt dhe të qetë.
- ❖ Ngacmimet,kacafytjet,zhurma dhe vrapimet në objektinshkollorë,koridore,
- ❖ Dhoma mësimore nuk janë të lejuara ,dhe cdo nxënës duhet të përgjigjet për vepra jo korrekte.
- ❖ Gjatë pauzes(pushimit) vizitat nëpër katet,ose klasat të tjera është vetëm me lejen e mësuesës kujdestar e mundur.
- ❖ Të ruhet rendi dhe qetësia gjatë blerjes së bukës në kantinë dhe të mundësohet pa probleme pagesa.
- ❖ Prishja e qellimshme e orendive shkollore, mjeteve mësimore,pronën e huaj edhe nese kerkohet falje nuk do të falet orenditë e dëmtuara duhet nga prindërit të kompenzohen respektivisht të paguhen .
- ❖ Për gjërat e humbura ,shkolla nuk merr kurrfarë përgjegjësie.
- ❖ Gjërat e gjetura në shkollë ruhen deri ne fundin e vitit shkollor në shkollë,e nese nuk i kërkon askush ato, ju falen fëmijëve më nevoj.
- ❖ Bicikletat duhet të vendosen në vendin e caktuar dhe të mbyllen me celës,nëse i vjedh dikush ato,shkolla(drejtorin) nuk merr kurrfarë përgjegjësie.
- ❖ Në orën e praktikës, mësuesjaj e praktikës do ti informoj nxënësit për makinat dhe mjetet e tjera të punës. Se sa janë ato të rrezikshme, të merren masat e sigurisë, dhe të mësojmë si të mbrohemi nga lëndimet e mundshme.
- ❖ Nxënës-at,prindërit dhe punëtorët ne shkollë janë të detyruar që rastet e veqanta si:ngacmimet ,bezdisjet në rrugë për në shkollë pa humbur kohë ti lajmërojnë në drejtorin e shkollës.

## **Gjësendet që nxënësit i sjellin me vete në shkollë**

- ❖ Gjësendet e rrezikshme që mund të pengojnë procesin mësimor në objektin shkollor janë të ndaluara.
- ❖ Nëse nxënësata bartin në shkollë gjësende, Gjësendi duhet të dorzohet mësimdhënësit deri sa të kryhen orët mësimore.
- ❖ Nëse gjësendi nuk është i rrezikshëm, i kthehet nxënësit. kurse gjërat e rrezikshme ju dorëzohen prindërve.
- ❖ Gjërat më vlerë si stoli, ari, shumica parash etj, nuk duhen të merren në shkollë. Nëse ato humbin, shkolla nuk merr kurrfarë përgjegjësie, për gjëra të humbura.
- ❖ Përdorimi i Inline-Skates, Roller-Skates, Skateboards dhe të ngjajshme janë në objektin shkollorë dhe në oborrin e shkollës të ndaluara.
- ❖ Përdorimi i telefonit (Hendit) në orën mësimore është i ndaluar. Edhe mësimdhënësit e përdorin telefonin vetëm në raste të veçanta (urgjente).
- ❖ Sipas Ligjit ABSB, shkolla e ka pë detyrë të kujdesen për nxënësit gjatë kohës së mësimit. Shkolla është e obliguar më ligj, nëse ndodh dështim më nxënësit ose dështim për nxënësit që kanë probleme të natyrave të ndryshme, edhe jashtë orarit mësimorë, shkolla më punëtorët e vetë janë të obliguar që rastin të lajmërojnë menjëherë në organet përkatëse

E përkthet (übersetzt von): Prof. Mark Demaj